

L I G J
Nr.8810, datë 17.5.2001

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS TË
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME "ALBTELECOM"**

(Ndryshuar me ligjin nr. 8912, datë 13.6.2002; Nr. 9127, datë 29.7.2003)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

(Shtuar tre paragrafë me ligjin nr. 9127, datë 29.7.2003)

Shoqëria anonime "Albtelecom" i nënshtrohet privatizimit.

Privatizimi i "Albtelecomit" sh.a. do të realizohet nëpërmjet transferimit të së drejtës së pronësisë të 100 për qind të aksioneve të zotëruara nga shteti të tretëve, sipas formulës së privatizimit të parashikuar në këtë ligj.

"Albtelecom" sha i jepet licencë për ofrimin e shërbimit publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, sipas standardit GSM, nëpërmjet shoqërisë së re të krijuar, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj.

Licenca jepet me kusht që:

- a) sigurimi i shërbimit të bëhet i bazuar në brezat e frekuencave 900 dhe 1800 MHz;
- b) ofrimi i shërbimit të fillojë jo më vonë se 12 muaj nga marrja e licencës;
- c) ofrimi i shërbimit të bëhet nga një shoqëri e re, ku "Albtelecom" sha të zotërojë 100 për qind të aksioneve. Kjo shoqëri të lidhë një marrëveshje, në kushte të barabarta, me "Albtelecom" sha, si operatorët e tjerë në treg.

Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, në zbatim të kushteve të parashikuara në paragrafin e mësipërm, të nenit 52 dhe të neneve vijuese të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", bën lëshimin, ndryshimin ose heqjen e licencës së lëshuar shoqërisë së re, përmendur në paragrafin e mësipërm.

Neni 2

(Shtuar paragraf në pikën 1 me ligjin nr. 9127, datë 29.7.2003)

Forma dhe formula e privatizimit të aksioneve të "Albtelecom" sh.a. është si vijon:

1. Jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kapitalit, u ofrohen investitorëve strategjikë të cilët janë shoqëri të specializuara në fushën e telekomunikacioneve.

Paketa e aksioneve të parashikuara në paragrafin e mësipërm do të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur ndërkombëtar dhe paguhet me USD. Madhësia e kësaj pakete përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pjesë e paketës së shitjes së "Albtelecom" sha të jetë dhe shoqëria e re që do të ofrojë shërbimin publik telefonik të lëvizshëm, tokësor, ku partnerit strategjik do t'i ofrohen jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kësaj shoqërie.

2. 3 (tre) për qind e aksioneve të kapitalit transferohet pa pagesë për llogari të "Albapost"

sh.a.

3. Paketa e mbetur e aksioneve të kapitalit u ofrohet subjekteve të mëposhtëm:

- Ish-pronarëve të mëparshëm të truallit dhe të ndërtesave, sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Punonjësve të “Albtelekom” sh.a., me anë të shkëmbimit të aksioneve me bonot e privatizimit të zotëruara prej tyre, duke përfshirë edhe ato të zotëruara, përfshirë nga familjarët e tyre (të tillë janë vetëm prindërit, bashkëshortët dhe fëmijët e punonjësve).

Në kuptim të këtij paragrafi, punonjës të shoqërisë vlerësohen punonjësit aktualë dhe ata të trajtuar me asistencë, sipas akteve ligjore në fuqi, një vit para publikimit të shoqërisë për privatizim.

4. Aksionet që mbeten pas procedurës së përshkruar në pikën 3, do të transferohen nëpërmjet ofertës publike dhe/ose me ankande publike, sipas akteve ligjore në fuqi.

Mënyra e transferimit dhe madhësia e kësaj pakete aksionesh do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Investitorët strategjikë, të cilët blejnë aksione sipas pikës 1, ushtrojnë të drejtën e parablerjes së aksioneve të kapitalit, të mbetura pas procedurës së përshkruar më sipër, nëse ka, duke paguar të njëjtin çmim për aksion sipas pikës 1. E drejta e parablerjes shuhet 1 vit pas përfundimit të procedurës së transferimit të aksioneve që u janë ofruar subjekteve sipas pikave 3 dhe 4.

6. Në rastin e një pakete të mbetur, pas përfundimit të afatit për parablerjen nga investitori strategjik, mënyra e transferimit të kësaj pakete do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke zbatuar procedurën e përshkruar në pikën 4.

Në kuptim të paragrafëve të pikave 4 dhe 6 nuk do të zbatohen nenet 206 dhe 207 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 3

Trajtimi i punonjësve që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit, në kuadër të privatizimit të “Albtelecom” sh.a. do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Fondet e nevojshme për një trajtim të tillë do të mbulohen nga të ardhurat e shoqërisë anonime “Albtelecom” përpara përfundimit të procesit të privatizimit. Pas përfundimit të këtij procesi, fondet që nevojiten për një trajtim të tillë, do të mbulohen nga të ardhurat e privatizimit, në përputhje me nenin 4 në vijim.

Neni 4

Të ardhurat nga privatizimi i Albtelecom sh.a. do të përdoren:

- për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e tenderit dhe për veprimtari të tjera, që nevojiten në procesin e privatizimit;

- për pagesën e tarifës së suksesit shoqërisë së huaj konsulente;

- për mbulimin e fondeve për trajtimin e punonjësve.

Pjesa që mbetet kalon në Buxhetin e Shtetit.

Masa e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i Albtelecom-it do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë dhe kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë anonime “Albtecom” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

(Ndryshuar emërtim me ligjin nr. 8912, datë 13.6.2002)

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve për kryerjen e të gjitha procedurave të tenderit ndërkombëtar për investitorët strategjikë me asistencën e shoqërisë së huaj konsulente.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3051, datë 5.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**